



13-12-2018

CHH

REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:059879

Datë: 01.10.2018

Numri i dokumentit: 00135706

P.nr.1828/17

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, me gjyqtarin e vetëm gjykes Ilir Bytyqi, me procesmbajtësen Mimoza Shabani, bashkëpunëtore profesionale, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga Ferizaj, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1001-3/17, të dt. 20.07.2017, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënie të urdhrit ndëshkimor - dënim me gjobë, gjykata me datën 24.09.2018 mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1001-3/17, të dt. 20.07.2017, dhe kjo gjykatë jepë këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri: [REDACTED] i lindur më [REDACTED], me vendbanim në Rr. [REDACTED] pn. Ferizaj, (përball [REDACTED]), nga i ati [REDACTED] dhe nëna [REDACTED] e vajzërisë [REDACTED] ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 27.05.2017, rreth orës 00:25, në rrugën "Naim Beka" në Ferizaj, duke drejtuar automjetin e markës Audi, targa të regjistrimi [REDACTED], ngjyrë e kuqe, nga pakujdesia ka rreziku

trafikun publik dhe jetën e njerëzve, në atë mënyrë që duke vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 41 pika 1 të LSKRR, ndërmerr veprim të pasigurt për tu kyçur në rrugë kryesore pa u bindur paraprakisht së me këtë veprim mund ta bëjë pa i rrezikuar pjesëmarrësit e tjerë, për pasoj në anësoren patë të anës së majtë është goditur nga automjeti i tipit Opell Astra, ngjyrë e kaltërt, targa [REDAKTUAR], e cila ishte duke lëvizur në drejtim të rrugën fshati Pleshin-Ferizaj, të cilën e ngiste [REDAKTUAR], nga ky aksident përveç dëmeve materiale lëndime trupore pësojnë [REDAKTUAR] dhe pasagjerja e njësisë një [REDAKTUAR].

me të cilën kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit të lartcekur dhe neneve 4,7,23,41,42,43,46,73, të KPRK-së, dhe në bazë të nenit 495 të KPPK-së, të pandehurin [REDAKTUAR] e

GJYKON

- Dënim në gjobë në shumë prej 200 Euro (dyqind), të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit.
- Në rastë se dënimi me gjobë nuk mundë të ekzekutohet në format tjera sipas nenit 46 të KPRK-së, i njëjti do të shndërrohet në dënim burgu ashtu që për çdo 20 euro, do të llogaritet 1 (një) ditë burg.
- Të dëmtuarit: [REDAKTUAR] nga Fsh. [REDAKTUAR] K. Ferizaj dhe [REDAKTUAR] ne Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore - juridike udhëzohen në kontest civil.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 Euro /njëzetë/, si dhe shpenzimet e procedurës penale expertiza mjeko-ligjore dhe expertiza e komunikacionit në shumën prej 90.88 Euro /nëntë dhjetë euro e tetëdhjetë e tetë cent/, në afatin prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguaj shumën prej 30 Euro /tridhjetë/, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.1001-3/17, të dt. 20.07.2017, ka akuzuar të pandehurin [REDAKTUAR] nga Ferizaj, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 6 lidhur me par. 1 të KPRK-së, njëherë aktakuzës i ka bashkangjitur kërkesë për dhënien e urdhrin ndëshkimor me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që vërtetojnë kryerjen e kësaj vepre penale nga ana e të pandehures.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për aprovimin e kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, në vështrim të nenit 495 par 1. të KPPK-së.

Gjykata duke i shikuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës si: mendimin dhe konstatimin e ekspertit të komunikacionit të dt. 22.06.2017, mendimin dhe konstatimin e ekspertit të mjekësisë-ligjore të dt. 15.06.2017, deklarata e të pandehurit të dhënë në hetuesi e datës 27.05.2017, fotografit të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe raportit i aksidentit 2017-CIFT-293 dt.27.05.2017, vlerësojë se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se e pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata të njëjtin e shpalli fajtorë dhe i shqiptoj dënimin me gjobë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi realizimit të kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

P.nr.1828/17 dt. 24.09.2018

Gjyqtari: Ilir BYTYQI



UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet kundërshtim në afatin prej 8 (tetë) ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit, gjyqtarit individual të kësaj gjykate përmes kësaj gjykate. Pas kalimit të afatit për kundërshtim, urdhëri ndëshkimor merrë formën e prerë dhe dënimi i shqiptuar ekzekutohet.